

## Detajet e çështjes

**Nr. i çështjes:** 31004-01479-86-2015

**Data e regjistrimit:** 18-03-2015

## Palët

**Paditës:** Defrim Selko

**I paditur:** Drejtoria e Pergjithshme e Doganave

**Objekti:** 1.Shfuqizimin e vendimit nr 13345/4 dt 11.7.2014 te Komisionit Disiplinor per marrjen e mases disiplinore te largimit nga sherbimi civil, si vendim I padrejte dhe I pambeshtetur ne prova dhe ne ligj 2.Rikthim ne pune 3.Demshperblimin per qendrimin padrejtesisht pa pune deri ne rikthimin ne pune

**Relatori:** Altina Nasufi

## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. 759, datë 26.12.2014 ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të padisë.
- Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave t'i paguajë paditësit Dëfrim Selko:
- 3 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës;
- 2 muaj si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;
- 12 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.
- 4 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë.
- Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda 12 muajve nga data e marrjes formë të prerë të këtij vendimi, duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Dëfrim Selko në 12 këste të barabarta mujore shumën përkatëse monetare dhe është një detyrim i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.
- Rrëzimin e padisë lidhur me kërkimet e tjera në padi si të pabazuar në prova dhe në ligj.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palëve ndërgjyqëse në raportet 60% në ngarkim të palës së paditur dhe 40% në ngarkim të palës paditëse.
- Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Dëfrim Selko shumën përkatëse monetare dhe është një detyrim i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

## Gjykata Administrative e Apelit, vendosi:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 759, datë 26.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

**Data e shpalljes:** 25-01-2017